



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur
më 14.3.2024, duke filluar në orën 11:00.

Në mbledhje morën pjesë: Trierë Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Feim Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Berat Lahu (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Petrit Reçica (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Radie Hoxhaj, (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Berna Saraçi (LVV), Ajet Brajshori (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Fatmir Dervishi, (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Gresa Lahu (PDK), Gëzim Mehmeti (AKR), Sami Boroci (AKR) dhe Fehmi Kupina (i pavarur).

Munguan: Endrit Zabërgja (NISMA), Agim Kuleta (LB), Pëllumb Bajçinovci, (LDK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Amir Simnica (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK) Bahri Gashi (AAK), Kushtrim Mushica (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK) dhe Valbona Ajeti (AAK).

Të pranishëm ishin edhe Valbona Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe përfaqësues të medieeve.

Mbledhjen e hapi anëtari më i moshuar, z. Ajet Brajshori dhe kërkoi nga të pranishmit 30 minuta pauzë, e që më pas të filloi mbledhja.

Përfaqësuesit e partive politike të pranishëm në sallë e kundërshtuan propozimin e z. Brajshori.

Ajet Brajshori, kryesuesi i mbledhjes, prapë kërkoi që të paktën mbledhja të shtyhet për 15 minuta, por edhe kësaj radhe përfaqësuesit e partive politike nuk e pranuan kërkesën e tij dhe pas këtij momenti z. Ajet Brajshori e lëshoi mbledhjen.

Faqe 1 nga 3

Në mungesë të kryesuesit të mbledhjes, mbledhjen e Kuvendit e udhëhoqi znj. **Nora Kelmendi**, e cila tha se, në bazë të kërkesës së grupit të asamblistëve është thirrur kjo seancë e jashtëzakonshme, me këtë

Rend dite:

1. Propozim-vendimi për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit.

Nora Kelmendi, kryesuese e mbledhjes, tha se, pasi që kjo seancë ka vetëm një pikë të rendit të ditës, e që është zgjedhja e kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit, kërkoi nga z. **Gëzim Sveçla**, si iniciues i kësaj seance të jashtëzakonshme, që ta paraqesë arsyeshmërinë e këtij propozim-vendimi.

Gëzim Sveçla tha se, siç po e shihni tash e sa kohë, kjo është gjendja e cila mbretëron si pasojë e LDK-së dhe kryetarit të kryeqytetit **Përparim Rama**, tendencë e vazhdueshme për kapje të çdo mekanizmi, çdo organi që ka të bëjë me kryeqytetin, në një kohë kur partia e tyre i ka vetëm 25% të votave. Ashtu siç jemi deklaruar publikisht, **Lëvizja Vetëvendosje** nuk ka kandidat të saj për kryesues të asamblesë komunale, me qëllim të lëvizjes së proceseve, të lëvizjes së gjërave përpara, ne heqim dorë nga ky propozim, edhe pse moralisht na takon, jemi grupi më i madh, 1/3 e asamblesë. Megjithatë, për të mirën e Kuvendit do ta mbështesim dhe do ta votojmë një kandidat i cili arrin të ketë mbështetjen e së paku 26 asamblistëve.

Nora Kelmendi, kryesuese, hapi diskutimin.

Gëzim Mehmeti, për kryesues të Kuvendit propozoi z. **Fehmi Kupina**.

Nora Kelmendi, kryesuese, tha se prezent në sallë janë 30 anëtarë të Kuvendit dhe kërkoi nga të pranishmit që të formohet një komision prej 3 anëtarëve, përfaqësues të partive politike, i cili do të mbikëqyrë mbarëvajtjen e procesit të votimit.

Gëzim Sveçla për anëtar të komisionit propozoi z. **Mirsad Vitia**.

Leutrim Retkoceri, për anëtar të komisionit propozoi znj. **Gresa Lahu**.

Gëzim Mehmeti, për anëtar të komisionit propozoi (vetëvetën) **Gëzim Mehmeti**.

Nora Kelmendi, kryesuese, konstatoi se njëzëri më 30 vota për u miratua formimi i komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit.

Nora Kelmendi, kryesuese, kërkoi nga komisioni që të fillojë procesi i votimit.

Mirsad Vitia në emër të komisionit, tha se më 20 vota për dhe 10 abstenime, nuk u miratua propozimi që z. Kupina të zgjidhet kryesuesi i Kuvendit, dhe kërkoi që procesi i votimit të vazhdojë edhe në raundin e dytë.

Mirsad Vitia, në emër të komisionit, tha se më 21 vota për dhe 9 abstenime, nuk u miratua propozimi për z. Kupina që të zgjidhet kryesues i Kuvendit dhe kërkoi që procesi i votimit të vazhdojë edhe në raundin e tretë.

Mirsad Vitia në emër të komisionit, tha se më 22 vota për dhe 8 abstenime, u miratua propozimi për zgjedhjen e z. Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit të Kryeqytetit.

Nora Kelmendi kryesuese, konstatoi se më 22 vota për dhe 8 abstenime, u miratua Vendimi për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Kryeqytetit.

Nora Kelmendi, kryesuese, ftoi z. Kupina për n një fjalë rasti.

Fehmi Kupina falënderoi të pranishmit për besimin e dhënë, zgjedhjen për të dytën herë në detyrën e kryesuesit të Kuvendit, brenda të njëjtit mandat. Në vazhdim ceku se, rizgjedhja për Kryesues të Kuvendit të Kryeqytetit është detyrim dhe përgjegjësi për mua, për çka zotohem sot para jush dhe qytetarëve të Prishtinës se do të vazhdoj të punoj me seriozitet dhe përkushtim maksimal për të mirën e përgjithshme publike dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve. Angazhimi im do t'i përkas vetëm punës së këtij Kuvendi, bashkëpunimit me ju dhe qytetarët e Prishtinës, me qëllim të bërjes së këtij qyteti, qytet me vlera kombëtare dhe ndërkombëtare, qytet të dashur dhe të dëshiruar për të gjithë, andaj dua të shpreh edhe njëherë mirënjohjen, falënderimin dhe konsideratën më të lartë për vendimin tuaj në zgjedhjen time si kryesues i Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesja e mbledhjes së Kuvendit
Nora Kelmendi



Faqe3nga3